




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 63.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 8.1 e) të Rregullës nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.05.2019, merr këtë:

V E N D I M

Mbi çregjistrimin e Partisë Politike

- I. Për mosdorëzim të të dhënave të ndryshuara vjetore, çregjistrohet nga regjistri i partive politike, Partia Politike, "**Partia e Fortë**" me akronimin PF.
- II. Partia Politike, "Partia e Fortë" me akronimin PF, nuk i ka përmbushur obligimet në afatin e shtuar prej njëzet (20) ditësh nga dita e pezullimit, që dalin nga neni 11 i Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- III. Kryetari dhe organet drejtuese të partisë politike "Partia e Fortë" me akronimin PF edhe pas marrjes së vendimit për çregjistrim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vazhdojnë të jenë përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe obligimet e krijuara gjatë periudhës së të qenurit aktiv.
- IV. Obligohet Zyra që ta fshij nga Regjistri i Partive Politike, Partinë "Partia e Fortë"
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Arsyetim

Partia Politike, "Partia e Fortë" me akronimin PF, e njoftuar për afatin ligjor shtese nuk ka dorëzuar as edhe në afatin shtesë prej 20 ditëve azhurnimet vjetore konform Rregullës nr. 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike. Pas rekomandimit të Zyrës, kjo parti politike është pezulluar me Vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datë 02.03.2018, në pajtim me nenin 6.1 c) dhe i është dhënë afat shtesë sipas nenit 6.1 cc) të Rregullës nr.01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

Këshilla juridike: Kryetari i Partisë Politike, "Partia e Fortë" me akronimin PF, z. Visar Arifaj, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, brenda 24 orëve nga marrja e Vendimit .

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

